

VENDIM
Nr. 99, datë 17.6.2016

MBI MIRATIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.6.2016, mbasi shqyrtoi draftlicencën dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, për miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Të miratojë licencën për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike (bashkëlidhur).
2. Efektet e kësaj licence për subjektet e licen-cuara përpara hyrjes së saj në fuqi, fillojnë me miratimin e këtij vendimi dhe për periudhën e mbetur të kohës së parashikuar në licencën aktuale.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsu-matorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

Republika e Shqipërisë
Enti Rregullator i Energjisë

LICENCË
PËR
PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Numri i licencës:

Certifikata e regjistrimit

Seria:

Data e hyrjes në fuqi:

Licenca i jepet:

Shoqëria:

NUIS:

Detyrimi për shërbimin publik:

Data e hyrjes në fuqi:

Kohëzgjatja:

Bazuar në autoritetin që i është dhënë në pjesën e pestë të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) i jep licencë prodhimi (licenca), për të kryer aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike (PEE) ose/dhe për të përmbushur detyrimin e shërbimit publik/universal, personit të lartpërmendur, i quajtur “i licencuari”, subjekt i kushteve të kësaj licence, si dhe kushteve të përcaktuar në vendimin e Bordit të ERE-s. Kjo licencë hyn në fuqi në datën e shkruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi për një periudhë prej _____, në rast se nuk përfundohet ose pezullohet nga ERE në përputhje me kushtet e licencës të përfshira këtu.

Kryetari i ERE-s

Republika e Shqipërisë
Enti Rregullator i Energjisë
KUSHTET E LICENCËS
PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Numri i licencës: _____

Seria: _____

I jepet: (emri i plotë i të licencuarit) _____

1. Dispozita të përgjithshme

1.1 ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur sipas pjesës së pestë të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, për të lëshuar dhe deklaruar hyrjen në fuqi të kësaj licence.

1.2 Nëse ndonjë kusht i kësaj licence bëhet nul ose shfuqizohet, ky kusht do të hiqet nga kushtet e licencës dhe kushtet e mbetura të licencës do të vazhdojnë të jenë plotësisht në fuqi.

1.3 Asetet e të licencuarve, me kapacitet të instaluar mbi 1 mw apo kur asetet të cilat kërkohet të transferohen, kalojnë vlerën prej 1.50.000.000 lekësh, kërkohet miratimi i ERE-s.

1.4 ERE ka të drejtën ekskluzive për të ndryshuar këtë licencë, në rast se kushtet dhe rrethanat kanë ndryshuar, si dhe për të përmbushur dispozitat e çdo Kodi Rrjeti, Kodi Shpërndarje, Kodi Matës dhe Rregulla Tregu, të miratuara nga ERE sipas legjislacionit në fuqi.

1.5 Në çdo kohë, i licencuari do të mbajë vetëm një licencë për prodhimin e energjisë elektrike.

1.6 Në këtë licencë, përfshirë kushtet e licencës dhe anekset e saj, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e përdorur do të kenë kuptimet sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si vijon:

“Shërbimet ndihmëse” janë shërbimet e nevojshme për operimin e qëndrueshëm të sistemit të transmetimit ose shpërndarjes.

“Biznesi shoqërues”, çdo biznes tjetër që direkt ose indirekt, tërësisht ose pjesërisht:

- 1) është pronë e të licencuarit; ose
- 2) ka pronësi të licencuarin; ose
- 3) është në pronësi të një personi, i cili është pronë e të licencuarit.

“Ndërsubvencionimet”, transferim fondesh ose ndarje kostosh brenda llogarive të të licencuarit ose mes bizneseve shoqëruese për mbështetje financiare të një aktiviteti ose biznesi me koston e një tjetri.

“Furnizim me energji elektrike” është shitja, përfshirë rishitjen e energjisë elektrike te klientët.

“ERE”, ERE do të thotë Enti Rregullator i Energjisë, që është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe i gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

“Forca madhore” është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si: tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmblytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.

“Prodhimi” është procesi i prodhimit të energjisë elektrike nga burime primare të energjisë.

“Njësi prodhimi” njësitë individuale dhe/ose pajisjet kryesore të impiantit ose impianteve të poseduara nga i licencuari për prodhim të energjisë elektrike, siç përshkruhen në mënyrë më të plotë në aneksin A.

“Legjislacioni në fuqi”, ligjet e Republikës së Shqipërisë të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë dhe aktet e tjera nënligjore të miratuara nga ERE apo organet e tjera të ngarkuara me ligj.

“Licencë” është një e drejtë që i jepet një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

“I licencuari”, personi që mban këtë licencë për prodhimin e energjisë elektrike, i përmendur në faqen e

parë të kësaj licence.

“Personi”, person do të thotë çdo person juridik i krijuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

“Central i energjisë elektrike” është një tërësi godinash dhe impiantesh të caktuara, të cilat kanë si funksion bazë prodhimin e energjisë elektrike.

“Sistemi i energjisë elektrike” është një sistem i ndërlidhur, i përbërë nga centralet elektrike, linjat elektrike, nënstacionet dhe pajisjet e transmetimit e shpërndarjes, me qëllim transmetimin apo shpërndarjen e energjisë elektrike te klientët.

“Tarifat e rregulluara”, një tarifë e aprovuar nga ERE sipas legjislacionit në fuqi.

Rregulloret dhe rregullat, standardet, kodet, rregulloret, urdhrat dhe rekomandime të tjera të miratuara nga ERE.

“Transferimi”, transferim do të thotë çdo shitje, dhënie me qira ose ndonjë disponim tjetër, i plotë ose i pjesshëm, i së drejtës për t’u angazhuar në aktivitetin e licencuar apo i aseteve që shërbejnë për aktivitetin e licencuar.

“Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)” është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.

“Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)” është një person juridik, përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar dhe, kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe eficiencën e energjisë.

“Shërbimi publik” është shërbimi që sigurohet nga një i licencuar që operon në sektorin e energjisë elektrike, që lidhet me sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, çmimet e rregulluara në sektorin e energjisë elektrike, eficiencën e energjisë elektrike, energjinë nga burimet e rinovueshme, mbrojtjen e mjedisit, përmbushja e të cilit nuk cenon konkurrencën, përveç kur është e domosdoshme për të siguruar shërbimin publik në fjalë.

2. Kryerja e aktivitetit të licencuar

2.1 I licencuari autorizohet nga kjo licencë për të ushtruar aktivitetin e licencuar në centralet elektrike që përdorin njësitë prodhuese të specifikuar në aneksin A. I licencuari, në çdo kohë dhe në çdo aspekt të aktivitetit të tij të licencuar, do të prodhojë energji elektrike në përputhje me standardet e miratuara në legjislacionin në fuqi.

2.2 I licencuari do të njoftojë menjëherë ERE-n për çdo ndryshim në fuqinë e instaluar të secilit prej njësisë prodhuese ose centraleve elektrike, të identifikuar në aneksin A, që rrisin ose ulin kapacitetin prodhues të disponueshëm nga i licencuari.

2.3 Çdo rritje e kapacitetit të instaluar, që kalon 10% të sasisë së kapacitetit të identifikuar në aneksin A, do të kërkojë një amendim të kësaj licence.

2.4 Në rrethanat e përcaktuara në nenin 36 të ligjit nr. 43/2015 dhe, me qëllim që të nxitet konkurrenca në tregun e energjisë elektrike, ERE, sipas kushteve të vendosura nga Këshilli i Ministrave, mund të kufizojë, herë pas here, kapacitetin total prodhues të autorizuar nga kjo licencë.

2.5 Jo më vonë se 30 ditë nga lëshimi i kësaj licence, i licencuari do të sigurojë jetën dhe shëndetin e njerëzve, si dhe asetet që shërbejnë për ushtrimin e aktivitetit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.6 I licencuari nuk do të pengojë, parandalojë ose tentojë të pengojë të licencuarit e tjerë ose konkurrentët potencialë që të angazhohen ose të hyjnë në mënyrë të ligjshme në një nga aktivitetet në sektorin e energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë.

2.7 I licencuari nuk do të angazhohet në ndërsubvencionime. I licencuari do të ndajë llogaritë e tij financiare sipas aktiviteteve që ushtron në përputhje me parashikimet e nenit 35, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

2.8 I licencuari nuk do të angazhohet në asnjë formë aktiviteti monopol të ndaluar nga legjislacioni në fuqi ose rregulloret dhe rregullat e aprovuara nga ERE.

2.9 I licencuari do ta kryejë aktivitetin e licencuar në përputhje me parimet e eficiencës ekonomike dhe objektivin për arritjen e kostove më të ulëta.

2.10 I licencuari do të informojë ERE-n, përpara se të fillojë çdo aktivitet tjetër të ndryshëm nga ai për të cilin është licencuar. ERE ka të drejtë të ndalojë ushtrimin e çdo aktiviteti tjetër të ndryshëm nga ai i të licencuarit kur e shikon të arsyeshme.

2.11 I licencuari nuk duhet të angazhohet në aktivitete të tjera, që pengojnë ose mund të pengojnë

kryerjen e duhur të aktivitetit të licencuar.

2.12 I licencuari do të informojë ERE-n para se të ndërmarrë ndonjë aktivitet, përveç aktivitetit të licencuar. ERE mund të marrë masa në lidhje me të licencuarin nëse kryen çdo aktivitet të ndaluar nga ERE, përveç aktivitetit të licencuar. Rastet në të cilat ERE mund të pengojë kryerjen e ndonjë aktiviteti tjetër kur qëllimi është mbrojtja e shëndetit të njerëzve apo raste të tjera të natyrës së forcës madhore.

3. Detyrimet e të licencuarit

I licencuari do të zbatojë legjislacionin në fuqi, përfshirë dhe detyrimet e shërbimit publik të caktuara në përputhje me ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

3.1 Regjistrimi

I licencuari do të regjistrohet si pjesëmarrës i tregut shqiptar të energjisë elektrike pranë operatorit të tregut sipas procedurave të regjistrimit dhe do të zbatojë parashikimet e VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe aktet nënligjore të miratuara nga ERE për këtë qëllim.

3.2 Llogaritë dhe raportimi

3.2.1 I licencuari do të mbajë regjistra llogarie dhe do të përgatisë bilance financiare konform legjislacionit në fuqi dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. I licencuari do t'i dorëzojë ERE-s bilancet financiare vjetore së bashku me raportet e auditit brenda datës 31 qershor të çdo viti.

3.2.2 I licencuari do të raportojë çdo muaj në ERE mbi energjinë e prodhuar gjatë një muaji, orët e punës, problematikat e hasura gjatë operimit. Të licencuarit i kërkohet të përgatisë dhe t'i paraqesë ERE-s deri më 31 janar të çdo viti, një raport vjetor lidhur me operimet e tij gjatë vitit kalendarik të mëparshëm dhe që përmban sa më poshtë:

- 1) një përmbledhje dhe analizë të aktiviteteve të të licencuarit;
- 2) prodhimin e energjisë elektrike gjatë vitit;
- 3) cilësinë e prodhimit dhe detaje të çdo mase të marrë për përmirësimin e cilësisë së prodhimit;
- 4) çdo defekt të ndodhur gjatë vitit;
- 5) detaje mbi çdo ndryshim të bërë në asetet e prodhimit, përfshirë detaje të çdo elementi që është zgjeruar, të nxjerra jashtë përdorimit ose zëve-ndësuar gjatë vitit.

3.2.3 Nëse i licencuari parashikon një situatë emergjence, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi, i licencuari do të njoftojë, pa vonesë, ERE-n dhe ky njoftim do të përshkruajë çfarë masash do të marrë i licencuari për të parandaluar ose përmirësuar ndikimet e situatës emergjente në prodhimin e energjisë elektrike.

3.2.4 I licencuari do të ndajë shpenzimet e përbashkëta mes aktivitetit të tij të licencuar dhe aktiviteteve të tjera (përfshirë dhe ato të licencuara). I licencuari do t'i paraqesë ERE-s dokumenta-cionin që tregon bazat për ndarjen e shpenzimeve të përbashkëta.

3.2.5 I licencuari do të njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të:

- a) adresës;
- b) statutit të të licencuarit;
- c) certifikatës së regjistrimit;
- d) NUIS;
- e) drejtuesve kryesorë;

3.2.6 Gjithë njoftimet zyrtare, aplikimet, peticionet, deklaratat ose korrespondenca tjetër me ERE-n, lidhur me detyrimet sipas kësaj licence, duhet të jenë me shkrim, duke caktuar respektivisht nga një zyrtar i autorizuar ose përfaqësues tjetër të të licencuarit ose të ERE-s. Këto dërgohen me korrier ose postë të regjistruar, duke kërkuar një verifikim të fletës së marrjes. Adresat e palëve duhet të vendosen mbi zarf. Gjithë njoftimet ose korrespondenca tjetër do të konsiderohen se hyjnë në fuqi nga momenti i dorëzimit, ose nëse nuk janë dorëzuar për shkak të gabimit të dërguesit, nga momenti i prezantimit. Do të konsiderohen të pranuar edhe gjithë njoftimet e dërguara përmes postës elektronike zyrtare të komunikuar më parë zyrtarisht nga palët.

3.3 Përdorimi i informacionit

3.3.1 I licencuari do të sigurojë që çdo informa-cion i marrë nga të tjerë si rezultat i aktivitetit të tij të licencuar nuk do t'i jepet askujt, me përjashtim të rasteve, kur:

- a) jepet pëlqimi paraprak me shkrim i personit me të cilin lidhet informacioni;
- b) kur informacioni është bërë publik;
- c) të licencuarit i kërkohet ose i lejohet të përhapë informacionin për të përmbushur kushtet e kësaj licence sipas një urdhri të ERE-s ose çdo dispozitë ligjore të aplikueshme.

3.3.2 I licencuari do të sigurojë që çdo biznes shoqërues nuk do të përdorë asnjë informacion në posedim të të licencuarit për të fituar një avantazh konkurrues të pajustifikuar dhe do të sigurojë që nuk do të përhapë asnjë informacion të ndonjë person tjetër (përfshirë ata të një biznesi tjetër shoqërues) gjë që do të

mundësonte këtë person të fitonte çdo lloj avantazhi komercial të pajustificuar.

3.3.3 Informacioni i dërguar ERE-s nga i licencuari do të konsiderohet publik me përjashtim të rasteve kur me kërkesë specifike të të licencuarit, ERE, me vendim, përcakton që ky informacion është i natyrës pronësore dhe se përhapja e tij nuk i shërben interesit publik.

3.3.4 I licencuari do të zbatojë kodet, rregulloret dhe rregullat e tjera të aprovuara nga ERE, si dhe rregullat e operimit dhe shfrytëzimit të OST-së, përfshirë kryerjen e gjithë urdhrave operativë, instruksioneve ose udhëzimeve dhe paraqitjen e informacionit teknik dhe gjithë dokumentacionit tjetër të kërkuar nga OST-ja apo OSSH-ja.

3.4 Detyrimet ndaj Operatorit të Sistemit të Transmetimit

3.4.1 I licencuari do të sigurojë shërbime ndihmëse sipas marrëveshjeve të lidhura me Operatorin e Sistemit të Transmetimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3.4.2 Marrëveshjet për shitblerjen e energjisë elektrike me çmime të rregulluara duhet të përputhen me kontratat model të miratuara nga ERE.

3.5 Rritja ose ulja e kapacitetit prodhues

3.5.1 I licencuari do të informojë ERE-n dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit mbi reduktimin e pjesshëm ose të plotë të kapacitetit prodhues, të paktën një vit para realizimit të tij duke paraqitur një shpjegim të detajuar për këtë qëllim. ERE mund ta përjashtojë të licencuarin nga ky detyrim në rast se reduktimi i kapacitetit të prodhimit shkaktohet nga një forcë madhore.

3.5.2 Mosmarrëveshja mes të licencuarit dhe një të licencuari tjetër, që ka të bëjë me një çështje brenda juridiksionit të ERE-s, që nuk mund të zgjidhet nëpërmjet negociatave të palëve, do të zgjidhet nga ERE, pasi të dëgjojë më parë palët, brenda qëllimit të autoritetit të ERE-s dhe në përputhje me rregulloret dhe rregullat e tij.

3.6 Pagesat e rregullimit

3.6.1 I licencuari do të paguajë pagesën e rregullimit në mënyrën e përcaktuar nga ERE gjatë afatit të kësaj licence në përputhje me nenin 17, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

3.6.2 Nëse i licencuari nuk i paguan ERE-s pagesat e rregullimit në përputhje me paragrafin 3.10.1, brenda afatit të përcaktuar në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i licencuari do të penalizohet në përputhje me nenin 107 të po këtij ligji.

4. Kontrolli mbi kryerjen e aktivitetit të licencuar

4.1 ERE do të monitorojë zbatimin e kushteve të licencës nga i licencuari, do të shqyrtojë raportet e marra nga i licencuari dhe, në çdo kohë, mund të monitorojë regjistrimet e llogarive të të licencuarit dhe të kërkojë një auditim teknik dhe/ose kontabël të aktiviteteve të tij.

4.2 Përfaqësues të autorizuar të ERE-s kanë të drejtë të monitorojnë objektet e të licencuarit, pajisjet dhe dokumentet e tij për të verifikuar përputhjen e kryerjes së aktivitetit të licencuar me kushtet e licencës, si dhe aktet ligjore në fuqi. I licencuari do të marrë çdo masë të nevojshme për të siguruar monitorimin nga ana e ERE-s pas marrjes së njoftimit.

4.3 Në bazë të ankesës së çdo pale të tretë ose në bazë të vetë propozimit të ERE-s, ky i fundit mund të nisë një hetim mbi zbatimin nga i licencuari të kushteve të licencës së tij ose të akteve ligjore në përputhje me kompetencën e ERE-s në sektorin e energjisë elektrike.

4.4 I licencuari do të informojë ERE-n duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës brenda 7 ditëve pune nga momenti kur kjo shkelje bëhet e njohur për të licencuarin.

4.5 Nëse pas hetimit ERE konkludon se i licencuari nuk i ka zbatuar kushtet e licencës, ERE mund të korrigjojë tarifën dhe kontratat e të licencuarit dhe/ose të marrë masa të tjera brenda qëllimit të autoritetit të tij për të mbrojtur interesat e konsumatorëve të energjisë elektrike.

4.6 I licencuari do t'u bindet vendimeve të marra nga ERE, përfshirë pagesën e gjobave të vendosura nga ERE, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Amendamenti i licencës

5.1 ERE mund të amendojë kushtet e licencës në rast si më poshtë:

- a) me iniciativë të ERE-s;
- b) në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë;
- c) kur ndryshojnë kushtet e kontratës koncesionare;
- d) me kërkesën e të licencuarit.

ERE merr në konsideratë ndikimet e pritshme që modifikimet e iniciuara apo të propozuara sjellin ndaj detyrimeve që i licencuari ka në përputhje me ligjin nr. 43/2015 dhe kushtet e licencës së tij, si dhe rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit, rinovimit dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

5.2. Përpara miratimit të modifikimit të një licence, ERE publikon modifikimet e propozuara dhe

shqyrton vërejtjet ose ankesat e mundshme, të paraqitura nga palët e interesuara lidhur me këtë proces.

6. Heqja e licencës

6.1 ERE heq një licencë kur i licencuari:

- a) nuk përmbush më kushtet thelbësore të licencës së dhënë;
- b) shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;
- c) rrezikon jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve;
- ç) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE;
- d) bëhet financiarisht i paaftë ose kërkon shpalljen e falimentimit;
- dh) me kërkesë të të licencuarit;
- e) ka pushuar së kryeri funksionet e caktuara sipas licencës.

6.2 Nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose nëse aksionari/ortaku që kontrollon interesat e të licencuarit ndryshohet pa autorizimin e ERE-s, licenca bëhet nul (e pavlefshme) dhe anulohet dhe pasuesi i të licencuarit do të aplikojë për një licencë të re në përputhje me procedurat e ERE-s për dhënie licence.

a) Kjo licencë mund të transferohet vetëm me vendim me shkrim të ERE-s dhe sipas afateve dhe kushteve të vendosura nga ERE. Çdo vendim i ERE-s për ndonjë transferim të kësaj licence do të jetë subjekt i gjykimit të ERE-s nëse personi të cilit i transferohet licenca do të ketë aftësinë teknike dhe financiare për të plotësuar afatet dhe kushtet e kësaj licence.

b) Çdo transferim i kësaj licence, pa miratimin e ERE-s, do të anulohet dhe do të përbëjë një shkelje të kësaj licence.

Kur licenca përfundon si pasojë e shkeljeve nga i licencuari të kushteve të licencës, i licencuari do të përgjigjet për koston që i shkakton ERE-s dhe pjesëmarrësve të tregut si rezultat i këtij përfundimi, siç përcaktohet nga ERE, përfshirë kostot lidhur me transferimin e rregullt të licencës të një i licencuar i ri.

c) Kur ERE përcakton se i licencuari ka shkelur një ose më shumë kushte të licencës, të licencuarit do t'i jepet një mundësi e arsyeshme për ta korrigjuar shkeljen para përfundimit të licencës. Përgjithësisht bëjnë rastet kur nga organet kompetente konstatohen shkelje të natyrës korruptive.

7. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe e drejta për apelim

7.1 Çdo çështje e diskutueshme ose kërkesë mes të licencuarit dhe çdo përdoruesi të sistemit të transmetimit lidhur me aktivitetin dispeçerues ose kushtet e licencës do të zgjidhet sa më shumë që të jetë e mundur me mirëkuptim.

7.2 Nëse zgjidhja nuk arrihet me mirëkuptim, atëherë ERE, në bazë të kërkesës së një prej palëve në mosmarrëveshje, do ta zgjidhë mosmarrëveshjen dhe do të nxjerrë vendimin e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7.3 Çdo palë në konflikt mund të apelojë kundër vendimeve të ERE-s në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.

7.4 “Subjektet e licencuara do të zbatojnë vendimet e ERE-s, deri në një vendim gjykate të formës së prerë”.

Republika e Shqipërisë Enti Rregullator i Energjisë

LICENCË

PËR

PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Seria:

Numri i licencës:

Licenca i jepet:

Data e hyrjes në fuqi të këtij aneksi:

ANEKSI A

LISTA E AUTORIZUAR E IMPJANTEVE DHE NJËSIVE GJENERUESE TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Impianti

Numri i Njesise

Kapaciteti I Instaluar

Dt. e Venies ne Sherbim
